



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 293/ prot.
2

Tiranë, më 07. 7. 2023

Lënda: Për riklasifikimin e pagave të punonjësve administrativë, në kuadër të VKM-së nr.325 datë 31.5.2023

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT
KUVENDI I SHQIPËRISË**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4, Tiranë

Për dijeni: **OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT**
Rruga e Kavajës, godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si një nga organet e sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë është miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë". Kjo strukturë ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me vendimin nr. 102/2018 dhe vendimin nr. 37/2022, të Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas Strukturës Organike të miratuar me vendimet e sipërcituara të Kuvendit, kategorizimi i pagave për punonjësit administrativë të institucionit është përcaktuar sipas kategorive të pagave në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, që rregullon pagat e nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.



Këto kategorizime kanë ndryshuar me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i cili ka shfuqizuar VKM-në nr. 187, datë 8.3.2017.

Ky vendim, në Kreun II - Kategoritë, klasat dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore, ka bërë një organizim të ri të klasave, pagës për pozicion dhe elementeve përbërëse të pagës bruto mujore dhe, sipas pikës 4 të Kreut IV të tij, kategorizimi i pagave të punonjësve administrativë të institucionit, deri në miratimin e strukturave dhe organikave të reja, duhet bërë sipas klasave të përcaktuara në këtë vendim, me efektet financiare që fillojnë nga data 1 prill 2023.

Gjithashtu, ngarkohen institucionet pjesë e fushës së veprimit të tij, të propozojnë ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese, për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave të përcaktuara në këtë vendim, duke bërë lidhjen midis klasave aktuale dhe atyre të reja.

Sa më sipër, bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 325, datë 31.5.2023, pika 4 e Kreut IV, kategorizimi i pagave për punonjësit e Njësive Administrative të Institucionit të Komisionerëve Publikë, është si vijon:

- Për pozicionin "Kancelar", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është I-a, klasifikimi i ri është I-1.
- Për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është II-b, klasifikimi i ri është II-1 (Drejtor drejtorie i përmbajtjes).
- Për pozicionin "Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është II-b, klasifikimi i ri është II-1 (Drejtor drejtorie që ka edhe funksione të Nëpunësit zbatues sipas legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit).
- Për pozicionin "Përkthyes", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është II-b, klasifikimi i ri është II-1.
- Për pozicionin "Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është III-a, klasifikimi i ri është III-1.
- Për pozicionin "Specialist", meqenëse klasifikimi i pagës aktuale është III-b, klasifikimi i ri është IV-1.



Funksioni	Klasifikimi i pagës për punonjësit administrativë të IKP-së	
	Aktuale	E përshtatur sipas VKM-së 325/2023
Kancelar	I-a	I-1
Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun	II-b	II-1
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse	II-b	II-1
Përkthyes	II-b	II-1
Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë	III-a	III-1
Specialist	III-b	IV-1

Në kushtet kur ndryshimi sipas VKM-së nr. 325, datë 31.5.2023, i klasave të pagave për punonjësit administrativ të institucionit, sjell nevojën për ndryshim të vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, të ndryshuar, përveç përshtatjes sipas klasave të reja të pagave, po ju parashtrajmë edhe një propozim për riklasifikim të pagave për disa kategori të punonjësve.

Me qëllim garantimin e një trajtimi financiar të përshtatshëm, i cili i referohet natyrës së punës dhe përgjegjësive gjatë ushtrimit të detyrës, veçorisë në funksionimin e institucioneve të rivlerësimit kalimtar, strukturës organike me pozicione atipike dhe grupimeve të proceseve të punës, vlerësojmë që:

1. Për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun”, të bëhet riklasifikimi i pagës në **I-4**, si drejtues i një drejtorie përgjegjëse jo vetëm për politikën kryesore të institucionit (drejtori e përmbajtjes), duke mbuluar gjithashtu marrëdhënien e institucionit me median dhe publikun në përmbushjen e misionit kryesor të Komisionerëve Publikë, përfaqësimin e interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar. Si drejtues i kësaj strukture, përgjigjet edhe për krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të Institucionit të Komisionerëve Publikë me institucione të huaja dhe organizma ndërkombëtare, në funksion të përmbushjes së objektit të veprimtarisë së institucionit, si dhe mbajtjen e marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Jashtme, Zyrën e Kryenegociatorit pranë Kryeministrit, në kuadër të procesit të integritetit. Drejtuesi i kësaj drejtorie është përballur me ngarkesën në rritje të punës në institucion në funksion të përmbushjes së afateve ligjore, menaxhimit të punës së Sekretarisë gjyqësore, përkthimit, redaktimit, publikimit dhe medias, denoncimeve nga publiku.



2. Për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse”, të bëhet riklasifikimi i pagës në **I-4**, si drejtues i një drejtorie jo vetëm me funksione të Nëpunësit zbatues sipas legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe përgjegjës për miradministrimin e fondeve buxhetore, por edhe drejtues i një strukture që përgjigjet për shërbimet mbështetëse të veprimtarisë institucionale, si Protokoll/Arkiv, strukturën e Burimeve Njerëzore, Teknologjinë e Informacionit etj. Kjo drejtori ka mbështetur veprimtarinë kryesore të institucionit, në të gjitha hallkat e saj, duke mbuluar ngarkesën për plotësimin dhe krijimin në kohë të kushteve optimale të punës. Në të gjitha institucionet e lidhjes 7, në kategorinë **II-1** janë kategorizuar vetëm Drejtorët e Drejtorive të Financës me funksion Nëpunës zbatues, ndërsa shërbimet mbështetëse janë drejtori e veçantë.

Pozicionet “Drejtor” në institucionet e rivlerësimit janë pozicione drejtuese atipike, që kanë grupuar disa procese pune ndryshe nga institucione të tjera, në të cilat këto procese pune janë të ndara në drejtori të veçanta. Për analogji, në vendimin e Këshillit të Ministrave mund të përmendim funksionin “Drejtor njësie”, në Kryeministri dhe Departamentin e Administratës Publike, të kategorizuar me klasë page **I-4**, si dhe Drejtorët e Përgjithshëm, në institucionet e tjera të pikës 1, me riklasifikim page nga **II-a** në **I-4**, që drejtojnë disa drejtori, të cilat kryejnë procese pune të veçanta me drejtues përkatës.

Këto drejtori me drejtues të përmbajtjes, drejtues me funksione të Nëpunësit zbatues dhe drejtues të drejtorive mbështetëse, që kanë procese pune të ndara, i gjejmë edhe në institucione, si: **ILD, KLGJ, SPAK, KLGJ, GJK., Gjykata e Lartë, etj.**, ndërkohë që në institucionet e rivlerësimit, këto procese mbulohen nga e njëjta drejtori.

Theksojmë, gjithashtu, se riklasifikimi i pagës për funksionin organik “Drejtor” rregullon edhe hierarkinë e pagave, pasi pozicioni “Përkthyes” në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun është trajtuar që, në fillim të veprimtarisë së institucionit, me klasë page të njëjtë me “Drejtorin”.

3. Për pozicionin “Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, të bëhet riklasifikimi i pagës në **II-1**.

Në këtë detyrë, Koordinatori kryen:

- Mbajtjen e marrëdhënieve me median e shkruar dhe audiovizive, ndjek çdo seancë gjyqësore, ku marrin pjesë Komisionerët Publikë, përgatit njoftimet për shtyp dhe ka komunikime të vazhdueshme deri në publikimin e tyre në media, pasqyron në kohë reale në media, njoftimet e ankimeve ose vendimeve të seancave gjyqësore, si dhe monitoron pa ndërprerë kanalet mediatike.
- Mbajtjen e marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Jashtme, Zyrën e Kryenegociatorit pranë Kryeministrit, duke marrë pjesë në takime, përgatitje raportimesh dhe qëndrimesh të institucionit, person kontakti për projekte të iniciuara, trajnime.



- Si koordinator për të Drejtën e Informimit, koordinim, përgatitje draft-përgjigjesh, vlerësim i situatave në kuadër të menaxhimit të shumicës së kërkesave për informacion dhe të gjitha detyrimeve që i lindin institucionit në kuadër të ligjit për të Drejtën e Informimit dhe zbatimit të udhëzimeve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit lidhur me Programin e Transparencës, përfshirë këtu edhe përditësimin periodik të këtij të fundit.

Në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, të ndryshuar, pozicioni i “Koordinatorit” është trajtuar si pozicion i veçantë në klasifikimin e pagës, duke e diferencuar nga specialisti i drejtorisë, në përputhje edhe me specifikën e veprimtarisë së institucionit.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, vihet re se kategoria e pagës e përcaktuar për pozicione të veçanta pune në institucione si Kryeministri (Koordinator) është klasa II-1, apo Agjencinë për Media dhe Informim (Koordinator në Agjencinë për Media dhe Informim) është klasa II-1 etj.

Ndryshimet e kërkuara në riklasifikimin e pagave në vijimësi edhe të ndryshimeve të mëparshme të strukturës dhe riklasifikimit të pagave të punonjësve të Institucionit të Komisionerëve Publikë, do të kenë një ndikim pozitiv në motivimin dhe qëndrueshmërinë e punonjësve administrativë, si dhe një ndikim të drejtpërdrejtë në përballimin e ngarkesës së shtuar të procesit të punës, drejt fundit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë.

Efektet financiare të riklasifikimit të pagave për këto pozicione pune për një vit buxhetor janë rreth 1,500,000 lekë.

Sa më sipër, i propozojmë Kuvendit, i cili ka kompetencën për miratimin e strukturës dhe klasifikimit të pagave për personelin e Institucionit të Komisionerëve Publikë, që në Lidhjen nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerëve Publikë”, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 37/2022, të bëhen këto ndryshime, paraqitur në dokumentin bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

KOMISIONERËT PUBLIKË

Florian Ballhysa

Erena Nino



ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

FUNKSIONI ORGANIK

I. KOMISIONERI PUBLIK

Komisionerë Publikë
Sekretarë

Klasifikimi i pagës	Numri
	(4)
G3*	2
Sekretar në kabinetin e ministrit**	2

II. KANCELAR

I-1	(1)
-----	-----

III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR

Këshilltarë juristë
Këshilltarë ekonomistë

	(10)
80% e pagës G3*	6
80% e pagës G3*	4

IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE
DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE
PUBLIKUNDrejtor
Specialist sekretarie
Specialist Redaktor gjuhësor
Përkthyes
Kordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë
Specialist Pritje me popullin

	(7)
I-4	1
IV-1	2
IV-1	1
IV-1	1
II-1	1
II-1	1
IV-1	1

V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSEDrejtor
Specialist Financë/Buxhet
Specialist i Burimeve Njerëzore
Specialist IT***
Specialist Protokoll/Arkiv****
Magazininier
Punonjës pastrimi
Shofer/Korrier

	(8)
I-4	1
IV-1	1
IV-1	1
IV-1	1
IV-1	1
IV-1	1
VI	1
II	1
V	1

Total**30****Shënim**

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për pozicionin e Sekretarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të Teknologjisë së Informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet Specialist Arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve.

